



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1786/6 prot.

Datë 22.10.2021

**V E N D I M**

**Nr. 794/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-03949-08-26-2021, me objekt: “*Shërbimi i pastrimit për degët e Agrokredit SHA*”, me fond limit 2,505,216 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Agrokredit SHA.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.  
Rr. “Fatmir Haxhiu”, P.2, Shk.10, Ap.76,Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agrokredit SHA  
Rruga Elbasanit, Nr. 178/1, NJ.A Nr.2, Bashkia Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit*”

*Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-03949-08-26-2021, me objekt: “*Shërbimi i pastrimit për degët e Agrokredit SHA*”, me fond limit 2,505,216 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Agrokredit SHA.

II.2. Në datën 15.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

“Pastrime Silvio” SHPK	2.203.700 lekë, skualifikuar
“Silver” SHPK	2.350.800 lekë, kualifikuar
“Clean Fast” SHPK	2.405.000 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

*Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” Shpk ka paraqitur Shtojcen 2 “Lista e cmimeve te sherbimeve”. Nga kontrolli i listes se cmimeve te sherbimeve te paraqitur rezulton se cmimi per Puntorine per pastrimin e zyrave ne dege, per 140 dite per secilen dege (30 dege total)*

*nuk respekton VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Kodin e Punes. Ne nenet 3 dhe 4 te VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” citohet: “3. Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë. 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë”. Ne Dokumentet e Tenderit, Shtojca 7 është kerkuar: Ne cmimin e ofruar per deget duhet patur parasysh VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI” dhe Kodi i Punes si dhe duhet te perfshihet edhe vlera e detergjenteve dhe mjeteve te pastrimit (sipas detajimit ne Formularin e Ofertes). Referuar ofertes se paraqitur nga shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k rezulton se per nje dite, per 30 dege, duke kryer pastrim per dy ore per secilen dege (sipas termave te references) operatori paguan punonjesit me 11.500 (njembedhjetë mijë e peseqind) leke, duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore. Vlera qe operatori ekonomik i paguan punonjesit per nje ore pune eshte 191.666 leke duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore. Paga qe duhet ti paguante operatori ekonomik punonjesve duke perfshire edhe sigurimet shoqerore ne masen 16,7% eshte: Paga minimale orare baze: 172,40 leke Sigurimet shoqerore 16,7% 28,79 leke Paga minimale orare baze (perfshire sigurimet shoqerore) 201,19 leke. Shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka planifikuar te paguaje punetoret me nje page me te ulet se paga e percaktuar ne VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe, ne kete menyre, nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit..*

II.3. Në datën 20.09.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike nr.140, të Agjencisë së Prokurimit Publik.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 23.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr prot 1675/2 date 09.09.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 4211/3 prot, datë 24.09.2021, me objekt “Kthim-përgjigje për ankimin”, protokolluar me tonën me nr. 1786/3 prot datë 27.09.2021, është dërguar për dijeni pranë Komisionit të Prokurimit Publik përgjigja e autoritetit kontraktor drejtuar shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1786/4 prot., datë 30.09.2021 me objekt: “Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK”, me

qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të dërgojë pranë këtij Komisioni të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e ankesës.

II.8. Në datën 06.10.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1786/5 prot., shkresa nr. 4211/5 prot., datë 04.10.2021 e autoritetit kontraktor me objekt: “Dërgim informacion”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi hartimin e dokumenteve të tenderit dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III


#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK se: *“Së pari; autoriteti kontraktor nuk ka njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve lidhur me klasifikimin përfundimtar dhe fillimin e afateve të ankimit. Jemi njohur nëpërmjet Buletinit të PP-së, të datës 20 shtator 2021, lidhur me klasifikimin përfundimtar të ofertave, në kundërshtim kjo me nenin 32, pika 2 të VKM-së nr. 285/2021, ku përcaktohet se: “Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë u lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të LPP-së dhe këtyre rregullave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1 Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve, lidhur me fazat aktive nëpër të cilat ka kaluar kjo procedurë, rezulton si vijon:



Objekti i Procedurës	Krijuar në	Statusi	Përfunduar në
● Kohëzgjatja dhe vlera e parashikuar	26.8.2021 11:14	Përfunduar	26.8.2021 11:15
● Zyrtaret e Prokurimit	26.8.2021 11:15	Përfunduar	26.8.2021 11:16
● Kriteret e Pjesëmarrjes	26.8.2021 11:16	Përfunduar	26.8.2021 11:20
● Kriteret e Vlerësimit	26.8.2021 11:20	Përfunduar	26.8.2021 11:20
● Dokumentet e Tenderit	26.8.2021 11:20	Përfunduar	26.8.2021 11:22
● Informacioni Administrativ	26.8.2021 11:22	Përfunduar	26.8.2021 11:24
● Njoftimi i Kontrates	26.8.2021 11:24	Përfunduar	26.8.2021 11:24
● Publikimi i Njoftimit të Kontrates	26.8.2021 11:24	Përfunduar	27.8.2021 13:01
● Dorezimi i Ofertave	27.8.2021 13:01	Përfunduar	7.9.2021 12:00
● Vleresimi i Ofertave	7.9.2021 12:00	Përfunduar	15.9.2021 10:39
● Kërkohet Ri-Vleresim?	15.9.2021 10:39	Përfunduar	15.9.2021 14:19
● Njoftimi i Fituesit	15.9.2021 14:19	Përfunduar	15.9.2021 14:21
● Publikimi i Njoftimit të Fituesit	15.9.2021 14:21	Përfunduar	16.9.2021 14:17
○ Konfirmimi i fituesit	16.9.2021 14:17	U hap	

III.1.2. Në nenin 97, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.”*

III.1.3. Në nenin 32, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, thuhet se:

*“1.Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. 2.Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109, të LPP-së, dhe këtyre rregullave.”*

III.1.4. Për sa më sipër rezulton se, në datën 15.09.2021 sistemi në mënyrë elektronike iu ka dërguar raportin e klasifikimit përfundimtar të gjithë ofertuesve pjesëmarrës, si dhe për shoqërinë “Pastrime Silvio” SHPK, sistemi ka dërguar në mënyrë elektronike njoftimin e skualifikimit duke përfshirë të gjitha arsyet e shënuara nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Pra në të njëjtën datë ankimuesi është njoftuar elektronikisht nga SPE-ja për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe arsyet konkrete të skualifikimit të tij. Duke qenë se ankimuesi ka marrë dijeni për njoftimin e fituesit në datën 20.09.2021, nëpërmjet publikimit të këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik, nga kjo datë fillojnë edhe afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, sikurse parashikohen në ligjin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në rastin konkret ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së brenda afateve ligjore të ankimimit, siç parashikohet në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 *“Afatet për ankimim”* të Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, ku thuhet shprehimisht se: *“2.Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7.Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “ [...] Në SPE nuk jemi njohur me të gjithë argumentimin e KVO-së, lidhur me skualifikimin tonë nga procedura. Në Buletinin e APP-së, autoriteti kontraktor ka publikuar edhe listën tonë të çmimeve (arsyetim më të zgjeruar), të cilin nuk na e ka njoftuar në SPE, në kundërshtim kjo me nenin 31 të VKM-së nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Ky njoftim përmban të gjitha arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në datën 15.09.2021 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht nga SPE-ja për të gjitha arsyet e skualifikimit të ofertës së tij dhe konkretisht:

“Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur Shtojcen 2 “Lista e cmimeve te sherbimeve”. Nga kontrolli i listes se cmimeve te sherbimeve te paraqitur rezulton se cmimi per Puntorine per pastrimin e zyrave ne dege. Per 140 dite per secilen dege (30 dege total) nuk respekton VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Kodin e Punes. Ne nenet 3 dhe 4 te VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” citohet: “3. Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë. 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë”. Ne Dokumentet e Tenderit, Shtojca 7 eshte kerkuar: Ne cmimin e ofruar per deget duhet patur parasysh VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI” dhe Kodi i Punes si dhe duhet te perfshihet edhe vlera e detergjenteve dhe mjeteve te pastrimit (sipas detajimit ne Formularin e Ofertes). Referuar ofertes se paraqitur nga shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k rezulton se per nje dite, per 30 dege, duke kryer pastrim per dy ore per secilen dege (sipas termave te references) operatori paguan punonjesit me 11.500 (njembedhjetë mijë e peseqind) leke, duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore. Vlera qe operatori ekonomik i paguan punonjesit per nje ore pune eshte 191.666 leke duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore. Paga qe duhet ti paguante operatori ekonomik punonjesve duke perfshire edhe sigurimet shoqerore ne masen 16,7% eshte: Paga minimale orare baze: 172,40 leke Sigurimet shoqerore 16,7% 28,79 leke Paga minimale orare baze (perfshire sigurimet shoqerore) 201,19 leke Shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka planifikuar te paguaje puntoret me nje page me te ulet se paga e percaktuar ne VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe, ne kete menyre, nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit.”

III.2.2. Në Njoftimin e Fituesit të publikuar në Buletinin e Njoftime Publike nr.140, datë 20.09.2021, arsyet e skualifikimit të shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK janë si vijon:

“Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur Shtojcen 2 “Lista e çmimeve te sherbimeve”.

**Lista e Çmimeve**

1	2	3	4	5	6
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (4 x 5)
1.	Puntori per pastrimin e zyrave ne dege. Per 140 dite per secilen dege (30 dege	Dite (sipas termave te references)	140	11,500	1,610,000

	<i>total).</i>				
2.	<i>Kove plastike per larje me mekanizem shtrydhes 12 l</i>	<i>Cope</i>	30	650	19,500
3.	<i>Peceta pastrimi microfiber</i>	<i>Cope</i>	720	300	216,000
4.	<i>Detergjent per pastrimin e dyshemese</i>	<i>Litra</i>	720	290	208,800
5.	<i>Shtupa per larje dyshemeje</i>	<i>Cope</i>	360	350	126,000
6.	<i>Detergjente per pastrimin e xhamave 750 ml</i>	<i>Cope</i>	90	260	23,400
			<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>		2,203,700
	<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>		2,203,700		
	<b>TVSH (%)</b>		440,740		
	<b>Çmimi total me TVSH:</b>		2,644,440		

Nga kontrolli i listes se cmimeve te shërbimeve te paraqitur rezulton se cmimi per **Puntorine per pastrimin e zyrave ne dege. Per 140 dite per secilen dege (30 dege total)** nuk respekton VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Kodin e Punes.

Ne nenet 3 dhe 4 te VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” citohet:

"3. Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë.

4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë".

Ne Dokumentet e Tenderit, Shtojca 7 eshte kerkuar:

**Ne cmimin e ofruar per deget duhet patur parasysh VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI” dhe Kodi i Punes si dhe duhet te perfshihet edhe vlera e detergjenteve dhe mjeteve te pastrimit (sipas detajimit ne Formularin e Ofertes).**

Referuar ofertes se paraqitur nga shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k rezulton se per nje dite, per 30 dege, duke kryer pastrim per dy ore per secilen dege (sipas termave te references) operatori paguan punonjesit me 11.500 (njembedhjetë mijë e peseqind) leke, duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore. Vlera qe operatori ekonomik i paguan punonjesit per nje ore pune eshte 191.666 leke duke perfshire ketu shtesen per sigurimet shoqerore.

Paga qe duhet ti paguante operatori ekonomik punonjesve duke perfshire edhe sigurimet shoqerore ne masen 16,7% eshte:

Paga minimale orare baze: 172,40 leke

Sigurimet shoqerore 16,7% 28,79 leke

Paga minimale orare baze (perfshire sigurimet shoqerore) 201,19 leke

Shoqeria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka planifikuar te paguaje puntoret me nje page me te ulet se paga e percaktuar ne VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe, ne kete menyre, nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit.”

III.2.3. Duke krahasuar informacionin që përmbajnë të dyja njoftimet e mësipërme, pra njoftimin sipas klasifikimit përfundimtar të ofertave dhe njoftimin e fituesit, rezulton se njoftimi i fitues përmban informacion më të hollësishëm, pasi përmban informacion shtesë lidhur me tabelën me listën e çmimeve të ofruara nga ankimuesi.

III.2.4. Mbështetur në nenin 31 të rregullave të prokurimit publik, njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve, përmban të gjitha arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi. Pra në rastin e skualifikimit të një ofertuesi, sistemi dërgon në mënyrë elektronike njoftimin e skualifikimit, duke përfshirë të gjitha arsyet e shënuara nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe këto arsye skualifikimi duhet të pasqyrohen edhe në Formularin e Njoftimit të Skualifikimit. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik (në lidhje me procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt-ankimi), pasi vlerësimi i bërë nga KVO në S.P.E duhet të ishte i njëjtë me atë të publikimit të njoftimit të fituesit, sic parashikohet në nenin 81 dhe 90 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 31 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe Manualin teknik “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike” të publikuar nga APP në SPE në datën 30.07.2021.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK se: *“Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k ka paraqitur Shtojcen 2 “Lista e çmimeve të shërbimeve”. Nga kontrolli i listës së çmimeve të shërbimeve të paraqitura rezulton se çmimi për Puntorinë për pastrimin e zyrave në dege, për 140 ditë për secilën dege (30 dege total) nuk respekton VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Kodin e Punes. Në nenet 3 dhe 4 të VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” citohet: “3. Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë. 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë”. Në Dokumentet e Tenderit, Shtojca 7 është kërkuar: Në çmimin e ofruar për deget duhet patur parasysh VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI” dhe Kodi i Punes si dhe duhet të përfshihet edhe vlera e detergjenteve dhe mjeteve të pastrimit (sipas detajimit në Formularin e Ofertes). Referuar ofertes së paraqitur nga shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k rezulton se per nje dite, per 30 dege, duke kryer pastrim per dy ore per secilen dege (sipas termave te references) operatori paguan punonjesit me 11.500 (njembedhjetë mijë e pesëqind) leke, duke përfshirë këtu shtesën për sigurimet shoqërore. Vlera që operatori ekonomik i paguan punonjesit për një orë punë është 191.666 leke duke përfshirë këtu shtesën për sigurimet shoqërore. Paga që duhet të paguante operatori ekonomik punonjesve duke përfshirë edhe sigurimet shoqërore në masën 16,7% është: Paga minimale orare baze: 172,40 leke Sigurimet shoqërore 16,7% 28,79 leke Paga minimale orare baze (përfshirë sigurimet shoqërore) 201,19 leke. Shoqëria “Pastrime Silvio” sh.p.k ka planifikuar të paguajë puntoret me një pagë me të ulët se paga e përcaktuar në VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe, në këtë mënyrë, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*



III.3.1. Në shtojcën 2 “Lista e çmimeve të shërbimit” të dokumenteve të tenderit, është kërkuar:

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofuara dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (4 x 5)</b>
1.	Puntori per pastrimin e zyrave ne dege. Per 140 dite per secilen dege (30 dege total).	Dite (sipas termave te references)	140		
2.	Kove plastike per larje me mekanizem shtrydhes 12 l	Cope	30		
3.	Peceta pastrimi microfiber	Cope	720		
4.	Detergjent per pastrimin e dyshemese	Litra	720		
5.	Shtupa per larje dyshemeje	Cope	360		
6.	Detergjente per pastrimin e xhamave 750 ml	Cope	90		
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					

III.3.2. Në shtojcën 7 “Termet e referencës”, pjesë e dokumenteve të tenderit, objekt-ankimimi, rezulton se është parashikuar si vijon:

**TERMAT E REFERENCES**

Shërbimi i pastrimit do te kryhet per zyrat e degeve te Agrokredit sh.a per nje periudhe 12 mujore:

Adresat dhe sipërfaqet e zyrave qendrore dhe degeve të shoqërisë "Agrokredit" shfaqen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Adresat e Degeve	Rrethi	Sipërfaqja /m <sup>2</sup>
1	Rruga "Dituria", perballë ish-Gjeologjisë Kukës	Kukës	90
2	Bulevardi «Elez Isufi», Lagja "Gjok Doçi". Diber.	Dibër	62
3	Rruga "28 Gushtit", hyrja 255, Bajram Curri Tropojë	Tropojë	50
4	Rruga "Luan Haradinaj", Lagjia Nr. 2, Qyteti Krumë.	Has	100
5	Lagjia Blloku Nr.1, Rruga «Ymer Puka», Pukë.	Pukë	70
6	Adresa: Rruga «At Gjergj Fishta», Pall 2/153, Kati i parë, Rreshen.	Mirditë	50
7	Rruga «Abdi Mati », Lagjia «Pjeter Budi», Pallati Nr.1, Kati i parë, Burrel.	Mat	31
8	SHKODER; Rruga Ëilson, Sheshi 2 Prilli	Shkoder	46
9	Rruga "ANTIPATREA", Lagjia "10 Korriku" Berat	Berat	60
10	Lagjia "Çlirimi", Skrapar.	Skrapar	34
11	Lagjia "Mustafa Matohiti", Rruga "Ali Pashe Tepelena" Tepelene	Tepelene	41
12	Bulevardi Kryesor, Gjirokastër.	Gjirokastër	50
13	Lagjia Nr.1, Rruga "ONHEZMI", Nr.8, Sarandë.	Sarandë	32
14	Lagjia «Partizani», Rruga «Mentor Xhemali», Pallati 46, Permet	Permet	46
15	Lagjia Nr. 2, Rruga "Ahmet Bektash", Pallati 35, Shkalla 1, Ap 3, Kati 1, Erseke.	Kolonjë	77
16	Rruga "Kico Greco", pallati City Center, Shkalla2, Ap.10 Korçë	Korçë	90
17	Lagjia Nr.1, Rruga Gani Butka, pranë Supermarket SPAR	Pogradec	61
18	Lagjia Nr. 1, ndertese dy katëshe, kati i dytë, pranë Qendrës, mbi Bankën Kombëtare Tregtare. Librazhd.	Librazhd	57
19	Lagjia "29 Nentori" rruga "Venedin Kollozi", Ap.1104 Vlorë	Vlorë	40
20	ELBASAN; Lagjia "28 Nentori", Rruga "Lublin Dilja, pallati 109, kati I ZK 8523	Elbasan	82
21	Lagjia Loni Dharmo, Rruga Misto Mame, Ndertesa e ish Posta e Vjeter	Lushnjë	57
22	Lagjia «Holta», Sheshi Qendrore, kati nën tokë Gramsh.	Gramsh	30
23	Lagjia Nr.17, Rruga Deshmoret, Pallati 930, Shkalla 1, Ap.2	Durrës	40
24	Lagjia Nr. 4, Shëtitorja "Indrit Cara", Kavajë.	Kavajë	58
25	Lagjia "I MAJI " Fier.	Fier	70
26	Nën Prefektura, Kati i parë, Lagjia e Re Bulqizë.	Bulqizë	40
27	Lagjia Nr.3. Devoll	Devoll	65
28	Lagjia "Beslidhja", Sheshi "Skenderbej", pranë Postes së qytetit Lezhe	Lezhe	32
29	Bulevardi Blu	Kamez	71.70
30	Pranë bashkisë së qytetit	Rrogozhinë	31.50

**Sherbimi i pastrimit të zyrave të degeve të Agrokredit sh.a do të përfshijë:**

- Pastrimin me aspirator të gjithë dyshemeve, mureve e tavaneve.
- Larjen e dyshemeve me uje me solucion lares.
- Pastrimin e thelluar të banjave.
- Pastrimin e pluhurit nga të gjitha tavolinat, raftet etj.
- Pastrimin e xhamave të fasadave të zyrave brenda dhe jashte.

### **Pastrimi ne dege**

Pastrimi ne dege do te kryhet per 30 dege, dy ore pune ne dite, nga ora 08.00 deri ne oren 10.00, per 140 dite ne vit. Pastrimi do te kryhet periodikisht gjate gjithë kohezgjatjes se marreveshjes kuader, sipas kerkeses se pergjegjesit te zyles se cdo dege te "Agrokredit" sha.

Ne llogaritjen e fondit limit eshte parashikuar qe pastrimi per cdo zyre te deges se shoqerise "Agrokredit" te kryhet 140 here gjate gjithë kohezgjatjes se marreveshjes kuader.

Ne cmimin e ofruar per deget duhet patur parasysh VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 "PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI" dhe Kodi i Punes si dhe duhet te perfshihet edhe vlera e detergjenteve dhe mjeteve te pastrimit (sipas detajimit ne Formularin e Ofertes)."

III.3.3. Në VKM Nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" thuhet:

1. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 172.4 (njëqind e shtatëdhjetë e dy pikë katër) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr. 809, datë 26.12.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021.

III.3.4. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK rezulton se është paraqitur formulari me listën e çmimeve si vijon:

#### **Lista e Çmimeve**

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (4 x 5)</b>
1.	Puntori per pastrimin e zyrave ne dege. Per 140 dite per secilen dege (30 dege total).	Dite (sipas termave te references)	140	11,500	1,610,000
2.	Kove plastike per larje me mekanizem shtrydhes 12 l	Cope	30	650	19,500
3.	Peceta pastrimi microfiber	Cope	720	300	216,000
4.	Detergjent per pastrimin e dyshemese	Litra	720	290	208,800
5.	Shtupa per larje dyshemeje	Cope	360	350	126,000
6.	Detergjente per pastrimin e xhamave 750 ml	Cope	90	260	23,400
				<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>	<b>2,203,700</b>
	<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>			<b>2,203,700</b>	
	<b>TVSH (%)</b>			<b>440,740</b>	
	<b>Çmimi total me TVSH:</b>			<b>2,644,440</b>	

III.3.5. Lidhur me arsyen e skualifikimit, ankimuesi ka argumentuar se: “Autoriteti kontraktor ka bërë një analizë dhe argumentim se oferta e paraqitur nga ana jonë nuk respekton VKM-në nr.1025/2020 dhe Kodin e Punës. Ky argumentim është diskriminues dhe jo transparent, në kundërshtim me parimet e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik. Ndalemi së pari tek oferta e operatorëve të tjerë ekonomikë, përderisa autoriteti kontraktor ka konstatuar se vetëm oferta jonë qenka në kundërshtim me VKM-në nr.1025/2020 dhe Kodin e Punës. Renditja përfundimtare e ofertave është si në vijim:

“Pastrime Silvio” SHPK	2.203.700 lekë, skualifikuar
“Silver” SHPK	2.350.800 lekë, kualifikuar
“Clean Fast” SHPK	2.405.000 lekë, kualifikuar

Diferenca ndërmjet ofertës sonë dhe ofertës së renditur më poshtë se e jona është vetëm 147.000 lekë pa TVSH, ndërsa me ofertën e tretë diferenca është vetëm 201.300 lekë pa TVSH. Në çfarë mënyre paska konstatuar KVO që do të bëhet shpërndarja e vlerës prej 147.100 lekësh apo 201.300 lekësh nga operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës për 30 degë të bankës, duke zbatuar parashikimet e VKM\_së nr. 1025/2020 mbi pagën minimale. Pra, vlerësimi i ofertës sonë është arbitrar dhe jo i arsyeshëm nga ana e KVO-së, gjë e cila vërtetohet lehtësisht nga oferta e operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Vlerësimi i ofertës sonë nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. KVO nuk ka vlerësuar në mënyrë të barabartë ofertën e paraqitur nga ana jonë dhe ofertat e paraqitura nga operatorët e tjerë të cilët i ka kualifikuar. Nga ana tjetër diferenca ndërmjet ofertës sonë dhe fondit limit është vetëm 301.516 lekë, duke krijuar dyshime që edhe vetë autoriteti, gjatë përcaktimit të fondit limit të procedurës, t’i jetë referuar VKM-së nr.1025/2020 dhe parashikimeve të Kodit të Punës. Nga ana tjetër, duke qenë se oferta jonë nuk është konsideruar anomalish e ulët, me të drejtë autoriteti nuk ka kërkuar sqarime për ofertën tonë. Ndërkohë në nenin 92 të, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 përcaktohet se: “[...]”. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar sqarime, gjithmonë në përputhje me parashikimet e mësipërme ligjore dhe absolutisht pa ndryshuar vlerën e ofertës. Ky sqarim nuk është bërë as për krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, në kundërshtim me këtë parashikim ligjor si dhe, pretendimet tona lidhur me ofertën e operatorëve të tjerë ekonomikë, me të cilët nuk kemi diferencë të konsiderueshme në ofertë, në mënyrë që të arrihet në konkluzionin që oferta jonë është në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Sqarojmë se sipërfaqet e degëve të Agro kredit SHA janë të vogla dhe 1 sanitare e caktuar për të pastruar një degë të kësaj shoqërie, do të qëndrojë 1 ose 2 orë për të realizuar shërbimin e pastrimit.”

III.3.6. Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

III.3.7. Në nenin 93 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.*

*4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.3.8. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe Vlerësimi i Ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

*Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

*- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

*- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalish e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

*Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalish të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.3.9. Sa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalish të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentet standarde të tenderit. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 93 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalish të ulëta.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalish të ulëta, pas përllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla, dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri, që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, (si qëllim parësor të LPP-së), por autoriteti kontraktor bindet me provat dhe argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me këtë ligj.

III.1.10. Në rastin konkret, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 2.203.700 lekë pa TVSH.

Nga përllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, oferta ekonomike e tij nuk rezulton anomalish e ulët, ndaj dhe në këtë rast, nuk ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 93 të LPP-së dhe nenit 82 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për sa i përket ofertës ekonomike të shoqërisë “Pastrime Silvio” SHPK.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i shërbimit të kërkuar është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka

detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të kërkuar është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-03949-08-26-2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit për degët e Agrokredit SHA”, me fond limit 2,505,216 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Agrokredit SHA.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK , duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**